

# IDENTITETI DHE SOVRANITETI JANË ELEMENTËT THELBËSOR TË SUPERSTRUKTURËS SHPIRTËRORE TË NJË KOMBI

Azgan **HAKLAJ**

Studiues, Akademia "Rrënjët Tona"

## PËRMBLEDHJE

Territori, origjina, historia, kufijtë etnokulturorë, gjuha, e më në fund toponimia janë elementët përbërës të identitetit, ndërkohë që sovraniteti nënkupton shtetin komb të shtrirë në arealin e kufijëve etnikë dhe aftësinë e tij për të unifikuar, administruar e mbrojtur këto territore. Veprimi i parë që bën një shtet, apo një perandori kur sundon me forcën e armëve territorin, apo një pjesë të tij të një shteti tjetër është zhdukja e identitetit të tij, si një premisë e sigurtë për asimilimin e gjuhës, historisë, fesë, dokeve dhe të kujtesës së tij historike. Një politikë të tillë ka ndjekur Serbia ndaj shqiptarëve, e sidomos ndaj atyre të trevave të veriut.

*Fjalë kyçe: origjina, kufij, komb, doke, fashizëm, asimilim.*

## ABSTRACT

Territory, origin, history, ethnocultural borders, language, and finally toponymy are the constituent elements of identity, while sovereignty means the nation-state lying in the area of ethnic borders and its ability to unify, administer and protect these territories. The first action taken by a state, or an empire, when it occupies the territory by force of arms, or a part of it of another state, is the disappearance of its identity, as a sure premise for the assimilation of language, history, religion, docks. and his historical memory. Such a policy has been pursued by Serbia towards the Albanians, especially towards those in the northern regions.

*Key words: origin, confines, nation, mores, fascism, assimilation.*

## HYRJE

Kjo politikë e ka zanafillën qysh 8 shekuj më parë nga zhupanët Stefan Nemanja, Car Uroshi i I, Car Uroshi i II e kulmoi me Stefan Deçanskin, e Car Dushanin Zhupanin e madh, të cilët sunduan me thundër të hekurt duke filluar në fund të shekullit të 12-të për afro dy shekuj në shekujt 13-të dhe gjysmën e parë të shekullit 14 -të, fantazma e të cilëve u ringjall në shekullin e 19- të me krijimin e Principatës së pavarur Serbe, në periudhën e Jugosllavisë Monarkike 1919-1944, të Federatës Titiste e Serbisë së Millosheviçit. Do të kthehem tek Perandori Stefan Dushani, jo vetëm për faktin se në kristovulën e tij gjatë sundimit gjakatar në gjysmën e parë të shekullit të 14- të gjendet për herë të parë i stamposur emri sllav "Tropojë", që do të thotë "Triopolje" tre fusha por në shumë troje të tjera shqiptare por edhe për të ndriçuar fytyrën gjakatare të këtij Bin Ladeni të mesjetës, i cili kishte një urrejtje patologjike për shqiptarët, për gjuhën, besimin e historinë e tyre, aq sa zhdukjen e identitetit dhunën e genocidin ndaj tyre e shnderroj në qëllim të vetëm të jetës se tij duke e sanksionuar edhe në ligjet drakoniane që nxori për këtë mision, të cilat u kodifikuan në vitin 1349 në kanunin e tij që fshiu të drejtën zakonore shqiptare. Edhe ata që mbrojnë variantin "Tre popat", popat ortodoks sllavë ishin. E përmenda qysh në fillim stampën me hekur të skuqur, sepse këtë fat kishin paraardhësit tanë, të cilët nuk pranonin të braktisnin besimin katolik për të marrë besimin ortodoks dhe nuk i nështroheshin pushtetit të tij barbar. Për mosbindje ndaj tij shqiptarët torturoheshin, vriteshin, deboheshin, ju konsfikohej pasuria, e më në fund stampoheshin me hekur të skuqur. Këto krime të përbindshme janë pasqyruar hollësisht në një letër që kardinali Guido ua dërgon Selisë së Shenjtë në Romë në vitin 1350.

## **IDENTITETI DHE SOVRANITETI - ELEMENTËT THELBËSOR TË SUPERSTRUKTURËS SHPIRTËRORE TË NJË KOMBI**

Ky relacion vuri menjëherë në lëvizje Selinë e Shenjtë, e cila u mobilizua për të organizuar një kryqëzatë antiserbe në mbrojtje të besimtarëve katolikë e të gjithë banorëve të atyre trojeve që vuanin nën pushtetin e tij tiranik të satrapit serb. Kjo kasaphanë ka ndodhur dy shekuj pas skizmës së madhe mes Kishës së Romës dhe asaj të Kostadinopojës të vitit 1054, kohë në të cilën Perandoria e Bizantit dhe Vatikani luftonin për të mbrojtur e shtrirë me tej demonet e ndikimin e kishave të tyre. Malësia e Gjakovës, apo Dardania Alpine si pikëtakimin e qytetërimit iliro - dardan dhe mbretërive të tyre tre-katër shekuj para lindjes së Krishtit është përballur me pushtues të shumtë, që nga romakët, stërgjyshërit e sllavëve hunët, serbët, turqit, maxharrët e deri tek nazistët gjermanë e fashistet italianë. Në qëndresën shekullore për mbijetesë është shquar fisi i fuqishëm i Gashit, i cili është pagëzuar me një emër biblik që në shqip do të thotë: "Sakrificë hyjnore"

Gashi shtrihej në territorin e Malësisë së Gjakovës, apo Dardanisë Alpine e deri në Nishin e Kostadinit të Madh e në Dardanë. Manastiri i famshëm i Deçanit dihej botërisht se ka qenë kryekulti i besimit katolik të gashianëve e të gjithë Rrafshit të Dukagjinit, para pushtimit serb. Barbarët e shkatërruan këtë tempull, ashtu si dhjetëra të tjerë në mbarë Dardaniën, edhe kjo e pagëzuar me emër serb "Kosovo" (vend mëllenjash), sorrash, e mbi themelet e saj e ngritën manastirin ortodoks, për ta përdorur si gozhdën e Nastradinit në shekujt e mëvonshëm, për konverimin fetar e tjetërsimin e identitetit racor. Barbarët sllavë ia arritën që ta rrafshojnë kishën katolike të Deçanit, ku kryen masakrat me çnjerëzore në Dardaniën antike e Dardaniën Alpine, në Rrafshin e Dukagjinit e në Gash të Gurit, por kursesi nuk i asimiluan për t'i zhdukur nga faqja e dheut siç endërronin. Në territorin e Gashit të Gurit shtrihet madhështor Olimpi Shqiptar Shkëlzeni, ku kanë selinë perenditë e lashta iliro-dardane, ku është Selia e vetë Zotit. Ky kolos është zemra e Shqipërisë etnike, Froni ku shihet si në pëllëmbë të dorës Rrafshi i Dukagjinit, bjeshkët me namë (të nemuna) të Kreshnikëve të Jutbinës, bjeshkët e Koshares ku prehet Omeri, fusha e Mejdanit ku Gjergj Elez Alija e preu kokën e bajlozit të zi, Lugina përrallore e Gashit e pranuar në Unesco, e në fund nga krahu tjetër pikëtakimi i Drinit me Valbonën dhe luginat e tyre magjepsese, të cilat vizitorët e udhërrëfyesit e huaj i kanë cilësuar me të drejtë si vendin e perëndive të Eskilit dhe një nga panoramat me të bukura të planetit. Dardania Alpine, apo Malësia e Gjakovës dhe Rrafshi i Dukagjinit e Gashi i Gurit në veçanti u kanë mbijetuar disa ekspeditave ushtarake shfarosëse asimiluese për shkak të papërkulshmërisë, veçoj këtu ato sllave, osmane, sulmeve të pashallarëve filoturq të Begollëve të Pejës, të shekujve 17-18<sup>të</sup>, të malazezëve e serbëve para Luftës së Parë Botërore, atë komuniste pas çlirimit nga fashizmi e rënies nën kthetrat e diktaturës.

Por le të kthehemi edhe njëherë në kohën e shembjes së Perandorisë së Stefan Dushanit. Malësia e Gjakovës, apo Dardania Alpine dhe Rrafshi i Dukagjinit pas shembjes së Perandorisë së Stefan Dushanit e ngritjës së principatave shqiptare është qeverisur nga familjet princërore të Spanëve e Dukagjinëve. Pjetër Spani e Lek Dukagjini pinjollë të këtyre dinastive ishin bashkëkohës dhe bashkëluftëtarë të Gjergj Kastriotit të cilët u bënë si krahët e shqipes për Heroin tonë Kombëtar dhe faktor determinues të asaj epoqeje të lavdishme, të cilën vëllezërit tanë të përtej detit e quajnë Moti i Madh i Arbërit. Pas pushtimit nga Perandoria Osmane dhe riorganizimit administrativ sipas modelit turk trojet shqiptare i ndanë në vilajete. Ajo që Stefan Dushani e vuloste serbisht "Tropojë" bënte pjesë në Kazanë e Gjakovës, të Sanxhakut të Pejës, pjesë e Vilajetit të Kosovës, me kryeqendër Shkupin. Ishte paria e Gashit ajo që ju drejtua me një letër Selisë së Shenjtë në vitin 1688 për ti ndihmuar në luftën çlirimtare. Stambolli me anë të Begollëve të Pejës ushtroj atëkohë dhunë e terror të paparë kundër gashianëve, ju dogji shtëpitë. I shpërnguli një pjesë të madhe të tyre nga trojet e veta. Shkatërroi Kisha e vrau katër priftërinj për të vënë në jetë planin e dirigjuar nga Qeveria Osmane për konvertimin me dhunë në fenë Islame. Këto ngjarje tragjike tërhoqën vëmendjen e Imzot Frang Bardhit, i cili i vizitoj vetë këto vise dhe i dergoj një

relacion të hollësishëm Atit të Shenjtë dhe Propogandës "Fide" në Romë. Gashi i Gurit i dha mbështetje të fuqishme me mijëra luftëtarë vullnetarë kryengritjes të udhëhequr nga Rilindasi European Pjetër Bogdani kundër hordhivë osmane në vitin 1689-1690. Edhe kjo kryengritje u shtyp me zjarr e hekur nga barbarët aziatikë. Pas Begollëve ishin malazezët ata që bënë të gjitha përpjekjet për të ndryshuar strukturën etnike të viseve tona të mbetura në Mal të Zi, të Gjakovës dhe rrethinave të saj. Çetnikët e knjaz Nikollës masakruan në Plavë-Guci qindra burra myslimanë që nuk pranuan të nderronin fenë. Konvertuan me dhunë qindra katolikë të Gjakovës në besimin ortodoks dhe i prenë duart priftit katolik vetëm se nuk pranoj t'i lutet Zotit në ritin ortodoks. Gjakova e Malësia e Gjakovës në të dy anët e kufirit tashmë të shembur nga UÇK-ja e lavdishme përgjithmonë ka qenë bastion i pamposhtur i lirisë, identitetit, e krenarisë kombëtare. Emri "Tropojë" i vulosur nga Car Deçanski e Car Dushani e i bekuar nga regjimi komunist satelit i Beogradit nuk është identiteti ynë.

## **PËRFUNDIME**

1. Dardania Alpine, apo Malësia e Gjakovës është amaneti i të parëve dhe Identiteti ynë.
2. Ndryshimi i emrit është kthim në identitet.
3. Kthimi në identitet është fillimi i bashkimit kombëtar dhe i krijimit të shtetit komb të shqiptarëve.
4. Në librin e tij ish kryeministri i Jugosllavisë Milovan Gjilasi thekson një bisedë me Stalinin kur ky e pyet për toponimet sllave ai përgjigjet: "Kur u kthyen shqiptarët vetë nuk i ndryshuan ato".
5. Por ky proces ka filluar me ndryshimin e emrit të Urës Vajgurore në Dimal.
6. Po vazhdon procesi për heqjen e emrit Çerovoda "Uji i Zi".
7. Ky fillim duhet të kthehet në strategji kombëtare për ndryshimin e të gjitha toponimeve të huaja.